**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA SHKODËR**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**
**Nr. 58 datë 30.09.2024**

## "PËR MIRATIMIN E RISHPËRNDARJES SË FONDIT BRËNDA TË NJËJTIT PROGRAM PËR VITIN 2024"

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 30.09.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 54 gërma "dh" të ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenit 54 pika "c" të ligjit Nr. 10465 datë 29.09.2011 " Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, VKM Nr. 475 datë 30.07.2021 "Për bashkëpunimin e njësive të vetëqeverisjes vendore me shërbimin veterinar" , ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, ligjit Nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, ligjit Nr. 97/2023 " Për Buxhetin e vitit 2024", Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 1 datë 24.01.2024", VKB Nr. 55 datë 29.12.2023 " Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër" të ndryshuar, Vendimit të Kryetarit të Bashkisë Nr.75 datë 23.02.2024 "Për miratimin e rishpërndarjes së fondit, brenda të njëjtit program për vitin 2024" , dhe sipas relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër,

**V E N D O S I**

1. Miratimin e rishpërndarjes së fondit nga programi 4220 " Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve" si më poshtë:

Pakësime viti 2024

Lekë

| Nr | Nr Programi | Programi | Aktiviteti/Emërtimi | Art.602 Mallra dhe Sherbime | Art.231 Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara | Institucioni Likuidues |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 4220<br>Kap. 1 | Sherbimet bujqesore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatoreve | P04220.Q1.O1.A1 Trajtimi i qenëve te rruges<br>*A2 Pajisje dhe medikamente për klinikën në strehëz* | 510,000 | | Bashkia Shkodër |
| | | **Totali** | | 510,000 | | |

Shtesa viti 2024

Lekë

| Nr | Nr Programi | Programi | Aktiviteti/Emërtimi | Art.602 Mallra dhe Sherbime | Art.231 Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara | Institucioni Likuidues |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 4220<br>Kap. 1 | Sherbimet bujqesore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatoreve | P04220.Q1.O1.A1 Trajtimi i qenve te rruges<br>*A6 Blerje pushkë CO2 për klinikën nëstrehëz* | | 510,000 | Bashkia Shkodër |
| | | **Totali** | | | 510,000 | |

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar.

Miratuar me 29 vota
Vota Pro 29
Vota Kundër 9
Vota Abstenim 1
Zbardhur me datë 01.10.2024

**SEKRETARE**

**Sabina Danaj**

**KRYETAR**

**Oltion LUCI**